

200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Fusha përmban titullin, informacionin tjetër për titullin dhe të dhënat për përgjegjësinë, që lidhen me titullin, përfshirë dhe çdo të dhënë të mësipërme të përsëritur në gjuhë të tjera (titujt paralel, të dhënat paralele për përgjegjësinë etj.). Kjo fushë është në përputhje me zonën e ISBD-së për titullin dhe përgjegjësinë. Tek koleksionet fusha mund të përmbaj periudhën e formimit të materialit dhe/ose periudhën e formimit të shumicës së materialeve, nëse kjo llogaritet si pjesë e titullit.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
200	Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë	nr
	a <i>Titulli i saktë</i>	r
	b <i>Përcaktimi i përgjithshëm i materialit</i>	r
	c <i>Titulli i saktë i veprës së autorit tjetër</i>	r
	d <i>Titulli i saktë paralel</i>	r
	e <i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
	f <i>Përgjegjësia parësore</i>	r
	g <i>Persona të tjerë përgjegjës</i>	r
	h <i>Numri i pjesës</i>	r
	i <i>Titulli i pjesës</i>	r
	j <i>Periudha e formimit të materialeve</i>	nr
	k <i>Periudha e formimit të shumicës së materialeve</i>	nr
	z <i>Gjuha e titullit të saktë paralel</i>	r

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		Rëndësia e titullit
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		Nuk është i përcaktuar

Vlera e treguesit tregon rëndësinë e titullit.

Vlera e treguesit është "1", nëse pikëqasja nuk është për emrin vetjak ose organizatën (shih shembujt 20, 23, 26, 27, 31, 37). Nëse vlera e treguesit është "0", në regjistrim duhet të jetë e pranishme fusha 700 ose 710. Në sistemet që shtypin skadat për katalogun manual, vlera "1" përcakton edhe përshkrimin shtesë për titullin.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

200a Titulli i saktë

Titulli i saktë i njësisë. Përfshin titullin alternativ, por jo informacionet e tjera për titullin (nëntitullin) dhe titujt paralel. Nëse njëzia përmban disa pjesë të të njëjtit autor dhe titujt e këtyre pjesëve ndodhen në faqen e titullit ose në faqen e saj zëvendësuese, përsëritet nënfusha a për çdo titull shtesë (shih shembujt 5, 19, 21). Nënfisha është e detyrueshme për çdo regjistrim.

200b Përcaktimi i përgjithshëm i materialit

Teksti i përcaktimit të përgjithshëm të materialit. Nënfisha përmban termin që në përgjithësi tregon llojin e materialit të cilit i përket njëzia, në gjuhën dhe shkrimin e institucionit që krijon regjistrimin. Termat e rekomanduar për përcaktimin e përgjithshme të materialit gjenden në ISBD-të për lloje të veçanta të materialit (shih shembujt 3, 9, 20, 21, 35, 36). Kur regjistrimi shfaqet, të dhënat janë të vendosura brenda kllapave katrore.

200c Titulli i saktë i veprës së autorit tjetër

Titulli i veprës së autorit tjetër, kur njëzia ka vepra të dy autorëve, pa titull të përbashkët (shih shembullin 10). Nënfisha c përsëritet për titullin e parë të secilit autor. Titujt e tjerë të autorit të dytë dhe autorëve të tjerë shënohen në nënfushat a, pas të cilave vendoset nënfusha përkatëse c (shih shembullin 25).

200d Titulli i saktë paralel

Titulli në gjuhën dhe/ose shkrimin tjetër që lidhet me titullin e saktë në nënfushën a ose c (shih shembujt 4, 11, 12, 28, 35, 37). E përsëritshme për çdo titull tjetër paralel (shih shembullin 38).

200e Informacioni tjetër për titullin

Informacioni tjetër për titullin (nëntitulli) në nënfushën a, c ose d (shih shembujt 1, 2, 20). E përsëritshme për çdo informacion tjetër për titullin dhe për informacionin paralel për titullin (shih shembujt 8, 14, 24, 37).

Në nënfushë nuk shënohen variantet e tjera të titullit siç janë: titulli në shpinën e librit, titulli i kapakut dhe titujt e tjerë që gjenden jashtë burimit kryesor të të dhënave.

200f Përgjegjësia parësore

Përgjegjësia parësore për titullin në nënfushën a, c ose d, ose për numrin apo titullin e pjesës në nënfushat h ose i. E përsëritshme pas çdo nënfushe a, c, d, h ose i, të cilës i takon përgjegjësia (shih shembujt 10, 25). E përsëritshme për çdo përgjegjësi paralele (shih shembujt 6, 24, 28).

200g Persona të tjerë përgjegjës

Lloji i përgjegjësisë që vije pas përgjegjësisë parësore dhe i përket të njëjtit titull. E përsëritshme për çdo përgjegjësi tjetër (shih shembujt 1, 30, 32, 35, 37, 38) dhe për çdo përgjegjësi tjetër paralele (shih shembullin 12).

200h Numri i pjesës

Numri i seksionit ose pjesës te njësitë me titull të përbashkët dhe të pjesës (shih shembujt 3, 30). E përsëritshme për çdo nënseksion ose ndarje tjetër (shih shembullin 9) dhe për çdo numër paralel të pjesës. Për shpjegime shtesë shih *Shtojca D*.

200i Titulli i pjesës

Titulli i seksionit ose pjesës te njësitë me titull të përbashkët dhe të pjesës (shih shembujt 3, 7, 30). E përsëritshme për çdo nënseksion ose ndarje tjetër (shih shembujt 9, 31, 32) dhe për çdo titull paralel të pjesës. Për shpjegime shtesë shih *Shtojca D*.

200j Periudha e formimit të materialeve

Periudha kohore e lidhur me formimin, përbërjen, mbledhjen dhe/ose administrimin si dhe përdorimin e materialeve në njësinë që përshkruhet, kur kjo është e nevojshme si pjesë e titullit. Mund të bëhet fjalë për distancën midis formimit të materialit më të hershëm dhe atij më të ri brenda koleksionit (shih shembujt 14, 33), datën unike, nëse të gjitha materialet nga koleksioni janë formuar në të njëjtin vit (shih shembullin 17), ose datat e ndara me presje, nëse ekziston boshllëk i madh në renditjen kronologjike të materialeve brenda koleksionit (shih shembullin 15). Sipas nevojës, mund të përdorni edhe një datë të përafërt.

200k Periudha e formimit të shumicës së materialeve

Datat që kanë të bëjnë me formimin e shumicës së materialeve në njësinë e përshkruar, nëse ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga periudha e formimit të materialeve në nënfushën j (shih shembullin 16).

200z Gjuha e titullit të saktë paralel

Kodi i gjuhës së titullit të saktë paralel në nënfushën d (shih shembujt 4, 11). Nëse nënfusha d përsëritet, duhet të përsëritet edhe nënfusha z, dhe në këtë mënyrë kodet e gjuhëve janë në të njëjtën renditje si titujt paralelë. Kjo nënfushë gjithmonë është e fundit brenda fushës.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Të dhënat në këtë fushë vendosen në formën dhe renditjen e përcaktuar nga ISBD-ja. Nënfusha z nuk është element i ISBD-së. Te shfaqja e regjistrimit shenjat e pikësimit vendosen në mënyrë automatike, përveç te të dhënat paralele në nënfushat 200e, f, g, h dhe i. Lidhja midis nënfushave dhe elementet e ISBD-së shfaqen në tabelë poshtë.

NËNFUSHA	EMRI I ELEMENTIT	PIKA ISBD(G)	SHENJA E PIKËSIMIT
a	Titulli i saktë	1.1	zonë e re
a (e përsëritur)	Titulli i saktë i autorit të njëjtë	1.6	;
b	Përcaktimi i përgjithshëm i materialit	1.2	[]
c	Titulli i saktë i autorit tjetër	1.6	.
d	Titulli paralel	1.3	=
e	Informacioni tjetër për titullin (nëntitulli)	1.4	:
f	Përgjegjësia parësore	1.5	/
g	Persona të tjerë përgjegjës	1.5	;
h	Numri i pjesës	1.1.4 ISBD(S)	.
i	Titulli i pjesës	1.1.4 ISBD(S)	, (nëse është pas 200h, përndryshe është .)

Të dhënat paralele

Të dhënat paralele (të dhënat e përsëritura në një gjuhë dhe/ose shkrim tjetër) që ndodhen në njësi, sipas ISBD-së u paraprinë shenja e barazimit. Te nënfusha 200d shenja e barazimit vendoset në mënyrë automatike, ndërsa te nënfushat e tjera me të dhëna paralele e vendos kataloguesi.

Nëse të gjitha të dhënat në burimin e përshkruar janë në më shumë një gjuhë, fillimisht shënohet grupi i të dhënave në njëren gjuhë (blloku gjuhësor) e më pas në gjuhën tjetër.

Nëse në burimin e përshkruar ndodhen vetëm të disa të dhëna paralele, nuk ndërtohet blloku gjuhësor, mirëpo nënfushat përkatëse në gjuhë të ndryshme vendosen së bashku njëra pas tjetrës (shih shembujt 6, 12, 24, 28, 38).

Përcaktimi i përgjithshëm i materialit

Përcaktimi i përgjithshëm i materialit bëhet në gjuhën dhe shkrimin e institucionit që krijon regjistrimin. Listat e përcaktuesve të përgjithshëm të materialit gjenden në ISBD-të përkatëse. Nëse njësia ka një titull kryesor të përbashkët dhe përmban disa pjesë përbërëse që i takojnë llojeve të ndryshme të materialeve, përcaktimi bëhet si: "Dy media", "Multimedia" ose "Komplet", të cilat do të bëjnë dallimin e materialeve.

Të tjera

Në fushën 500 – *Titulli uniform* vendoset forma e vendosur e titullit të veprës, që ka dalë me tituj të ndryshëm, botime e përkthime të ndryshme etj. (shih shembujt 22, 33).

Titulli i përkthyer nga kataloguesit vendoset në fushën 541 – *Titulli i përkthyer i vënë nga kataloguesi*.

Nëse titulli i saktë përmban shkurtesa, initiale, numra ose simbole, forma e zgjeruar e titullit vendoset në fushën 532 – *Titulli i zgjeruar* (shih shembullin 29).

Titulli me simbole matematike dhe simbole të tjera të veçanta mund të vendoset në fushën 539 – *Titulli i saktë me komandat L^AT_EX** (shih *Shtojca E*).

Për kërkimin dhe indeksin në bibliografi, të dhënat për veprat e autorëve të tjerë fiksohen në fushat 423 – *Vepra e shtuar, e fshehur dhe e përfshirë* (shih shembujt 10, 25, 26, 27).

Kur titulli fillon me një të shquar ose të pashquar (ose me ndonjë fjalë tjetër të paklasifikuar), nyja vendoset mes dy shenjave për klasifikim NSB/NSE "¶", duke lënë hapësirë pas nyjes. Në këtë mënyrë nyja nuk do të respektohet në klasifikim dhe në kërkim (shih shembujt 1, 13, 30).

Nëse titullin e njësisë e përbëjnë titujt e veprave të veçanta të lidhur mes vete gramatikisht, lidhësja vendoset në nënfushën e titullit që paraprihet nga lidhësja (shih shembullin 5).

Të dhënat që nuk shënohen zëvendësohen me "... [et al.]" ose me termat përkatës në shkrim jolatin (shih shembullin 23).

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

101 GJUHA E NJËSISË

Nëse gjuha e titullit të saktë në nënfushën 200a ndryshon nga gjuha e tekstit, gjuha e titullit të saktë vendoset në nënfushën 101g. Gjuha e titullit paralel vendoset në nënfushën 200z.

423 VEpra e SHTUAR, e FSHEHUR DHE e PËRFSHIRË

Përdoret për shënimin e të dhënave për njësitë bibliografike, të cilat janë botuar bashkë me njësinë e përshkruar.

5XX BLOKU I TITUJVE NË LIDHSHMËRI

Përdoret për titujt në gjuhët e tjera dhe për variantet e titujve (p.sh. titulli në shqip).

530 TITULLI KYÇ

Titulli kyç i burimit në vazhdim.

7XX BLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË

Emrat e lidhur me përgjegjësinë vendosen në bllokun 7XX.

SHEMBUJ

1.

200	0□	a#The †Great Fear of 1789 erural panic in revolutionary France f[by] Georges LeFebvre gtranslated from the French by Joan White gintroduction by George Rudé (Nyja "The" nuk respektohet te klasifikimi i regjistrimeve me titull të saktë.)
-----	----	---

Shfaqja në formatin ISBD:

The Great Fear of 1789 : rural panic in revolutionary France / [by] Georges LeFebvre ; translated from the French by Joan White ; introduction by George Rudé

2.

200 1□ **a**What is modern mathematics? **e**a guide to teachers in further education
fYorkshire and Humberside Council for Further Education
(Pikëpyetja "?" në titullin e saktë gjatë përshkrimit bibliografik vendoset ashtu siç është në njësi)

Shfaqja në formatin ISBD:

What is modern mathematics? : a guide to teachers in further education / Yorkshire and Humberside Council for Further Education

3.

200 1□ **a**Bulletin signalétique **h**Section 9 **i**Sciences de l'ingénieur **b**Microform **f**Centre national de la recherche scientifique
(Përcaktimi i përgjithshëm i materialit në nënfushën b është në gjuhën e institucionit që ka krijuar regjistrimin. Kjo e dhënë vendoset pas nënfushave h dhe i.)

Shfaqja në formatin ISBD:

Bulletin signalétique. Section 9, Sciences de l'ingénieur [Microform] / Centre national de la recherche scientifique

4.

200 1□ **a**Industrialsteam locomotives of Germany and Austria **d**Dampfloks auf Industriebahnen der BRD, DDR, und Österreich **f**compiled by Brian Rumar
gGerman translations by M. Spellen **z**ger
510 1□ **a**Dampfloks auf Industriebahnen der BRD, DDR, und Österreich **z**ger
(Botimi ka titull paralel në gjuhën gjermane. Institucionit katalogues i nevojitet përshkrimi shtesë për titullin paralel, për këtë arsye titulli paralel është vendosur edhe në fushën 510.)

5.

200 0□ **a**Flash and filigree **a**and, The Magic Christian **f**by Terry Southern
(Botimi përmban dy vepra të autorit të njëjtë, ku secila ka titullin e saj.)

6.

200 1□ **a**Bibliographica belgica **f**Commission belge de bibliographie **f**= Belgische Commissie voor bibliografie
(Botimi ka titull në latinisht, ndërsa përgjegjësia është e shënuar në gjuhën franceze dhe holandeze. Para shënimit të përgjegjësive paralele në nënfushën f duhet të vendosen shenja e barazimit dhe hapësirë "=".)

7.

200 0□ **a**Three adventures of Asterix **i**Asterix in Switzerland **f**text by Goscinny **g**drawings by Uderzo **g**translated by Anthea Bell and Derek Hockridge

(Regjistrim për një rën nga tri vëllimet e panumërtuara, që kanë titull të përbashkët, por secili vëllim ka edhe titullin e tij. Përgjegjësia parësore është vendosur në nënfushën f, ndërsa të tjerat në nënfushat g. Mund të jenë disa autorë.)

8.

200 0□ **a**Life wish ereincarnation ereality of hoax **f**Maurice Rawlings
(Shembull i disa informacioneve të tjera për titullin (disa nëntituj.)

9.

200 1□ **a**British standard methods of analysis of fat and fatty oils **h**Part 1 **i**Physical methods **h**Section 1.12 **i**Determination of the dilation of fats **b**Printed text
(Standard me seksione dhe nënseksione në bibliografitë e llojeve të ndryshme të botimeve.)

10.

200 0□ **a**Pour les valeurs bourgeoises **f**par Georges Hourdin **c**Contre les valeurs bourgeoises **f**par Gilbert Ganne
423 □1 **1**2000□ **a**Contre les valeurs bourgeoises **1**700□1 **a**Ganne, **b**Gilbert
(Botimi përmban dy vepra të autorëve të ndryshëm, pa titull të përbashkët. Nënfusha f përsëritet pas çdo titulli. Të dhënat për veprën e autorit të dytë fiksohen në fushën 423. Institucionit katalogues i nevojitet përshkrimi shtesë, për këtë arsye vlera e treguesit është "1".)

Shfaqja në formatin ISBD:

Pour les valeurs bourgeoises / par Georges Hourdin. Contre les valeurs bourgeoises / par Gilbert Ganne

11.

200 0□ **a**Applications of ecological (biophysical) land classification in Canada **e**proceedings of the second meeting **d**Applications de la classification écologique (biophysicale) du territoire au Canada **e**compte rendu de la deuxième réunion **f**Canada Committee on Ecological (Biophysical) Land Classification, 4-7 April 1978, Victoria, British Columbia **g**compiled and edited by C.D.A. Rubec **z**fre
(Titulli dhe informacioni tjetër për titullin janë në gjuhën angleze dhe franceze, ndërsa përgjegjësitë nuk kanë forma paralele.)

12.

200 0□ **a**Printing at Gregynog **e**aspects of a great private press **d**Argraffu yng Ngregynog **e**agweddau ar wasg breifat fawr **f**Michael Hutchins **g**translated by David Jenkyns **g**= y cyfieithiad gan David Jenkyns **z**wel
(Përgjegjësia parësore është e njëjtë për të dyja gjuhët. Para përgjegjësive paralele në nënfushën e përsëritshme g vendoset shenja e barazimit dhe hapësirë "=".)

13.

200 1□ **a**Le †western, nouvelle éd. **c**Évolution et renouveau du western (1962-1968)
(Botimi nuk ka titull të përbashkët dhe për këtë arsye të dhënat e botimit për njërin nga titujt janë vendosur në zonën e titullit dhe jo në zonën e botimit. Në regjistrim kjo e dhënë është vendosur si pjesë e titullit të saktë, gjë e cila nuk është diçka e zakonshme.)

14.

200 1□ **a**Ворошилов Климент Ефремович. Партийный и государственный деятель. 1881-1969 **j**1920-1960
(Arkivi i Kliment Vorošilov (1881–1969), materiali në arkiv daton midis viteve 1920 dhe 1960.)

15.

200 1□ **a**Выпускницы Высших Бестужевских курсов **j**1880-e–1983, 1987
(Koleksioni arkivor përfshinë shënimet e diplomantëve të ligjëratarave të Bestužev. Shënimet janë nga periudha e viteve të tetëdhjeta të shekullit 19 deri në vitin 1983 si dhe nga viti 1987 (nga periudha 1984–1986 nuk ekzistojnë dokumente). Data e krijimit të shënimit më të hershëm është e përafërt.)

16.

200 1□ **a**Шаховская Зинаида Алексеевна (Малевская-Малевич, Жак-Крузе). Княгиня, писательница, редактор. 1906 - **j**1877-1996 **k**1923-1996
(Arkivi i Zinaida Shahovska (princesë ruse, shkrimtare dhe poete, që ka krijuar nën pseudonimin Jaques Croise). Arkivi përfshinë materialet nga periudha midis viteve 1877 dhe 1996, ndërsa shumica e materialeve buron nga periudha midis viteve 1923 dhe 1996.)

17.

200 1□ **a**Автобиография А.А.Адамова с приложением фотографии **j**7 июля 1937
(Dokument nga arkivi rus i emigrantëve përmban autobiografinë e A. Adamov të datës 7 korrik 1937.)

18. * COBISS.net

200 0□ **a**Organizimi i informacionit emual për përdorimin e burimeve elektronike epër nxënësit e shkollave të mesme **f**Robert Barry **g**[përkthyes Olsi Deda]
(Regjistrim për botimin me dy informacione për titullin (dy nëntituj). Përgjegjësia parësore është në nënfushën f, ndërsa përgjegjësia dytësore në nënfushën g. E dhëna për përkthyesin nuk ndodhet në faqen e titullit, për këtë arsye është vënë brenda kllapave katrore.)

19. *

200 0□ **a**Grivarjevi otroci **a**Pastirci **a**Pestna **f**France Bevk **g**[sprema beseda in opombe Martina Šircelj]
(Botimi ka tri vepra të të njëjtit autor, secila vepër ka titullin e saj.)

20. * COBISS.net

200 1□ **a**World ocean atlas 2001 **b**Burim elektronik eobjectively analyzed fields and statistics **f**prepared by the Ocean Climate Laboratory, National Oceanographic Data Center **g**editor Sidney Levitus
(Regjistrim për atlasin në CD-ROM. Përcaktimi i përgjithshëm i materialit në nënfushën b është në gjuhën e institucionit që ka krijuar regjistrimin.)

21. * COBISS.net

200 0□ **a**Serenata **b**Regjistrim zanor **a**Zonjës **a**Një lule e vyshkur **a**Ylber ekantatë **f**Shpresa Goga
(Regjistrim për regjistrimin zanor që përmban katër vepra të autorit të njëjtë.)

22. * COBISS.net

200	0□	a Si të zhvillojmë inteligjencën emocionale f Christian Weisbach dhe Ursula Dachs g [përktheu Mariana Luka]
500	00	a Piesek przydrożny m gjuha shqipe (Regjistrim për veprën e përkthyer. Titulli i origjinalit në gjuhën polake vendoset në fushën 500. Në nënfushën 500m vendoset gjuha e titullit të saktë kryesor nga 200a.)

23. *

200	1□	a Visokogorska jezera v vzhodnem delu Julijskih Alp d High-mountain lakes in the Eastern part of the Julian Alps f urednik Anton Brancelj g prevajalci Marjeta Humar ... [et al.] g avtorji fotografij Jure Andjelič ... [et al.] (Regjistrim për veprën anonime. Vlera e treguesit duhet të jetë "1". Botimi ka titullin paralel në gjuhën angleze. Kur llojin e njëjtë të përgjegjësive e kanë më shumë se tre autorë, shënohet vetëm i pari dhe më pas shënohen "... [et al.]".)
-----	----	---

24. * COBISS.net

200	0□	a Magdalena ekatalog festivali e = festival catalogue f Festivali Ndërkombëtar i Komunikimit Vizual f = International Festival of Visual Communications (Botimi ka titull në gjuhën shqipe dhe informacion tjetër për titullin e të dhëna për përgjegjësinë në gjuhën shqipe e angleze. Nënfishat e dhe f janë të përsëritshme, ndërsa para të dhënave paralele shënohet shenja e barazimit dhe hapësirë "= ").)
-----	----	---

25. *

200	0□	a Die # Planeten b Regjistrim zanor f Gustav Holst c Unheimliche Begegnung der dritten Art a Krieg der Sterne f John Williams g [[in allen Werken] Frauenstimmen des Los Angeles Master Chorale g Los Angeles Philharmonic Orchestra g geleitet von Zubin Mehta]
423	□0	1 2000□ a Unheimliche Begegnung der dritten Art a Krieg der Sterne a Unheimliche Begegnung der dritten Art 1 700□1 a Williams b John 4 230 (Botimi përmban tri vepra të dy autorëve të ndryshëm, pa titull të përbashkët. Të dhënat për veprat e autorit të dytë fiksohen në fushën 423, ndërsa e dhëna për autorin nuk përsëritet në fushën 701.)

26. * COBISS.net

200	1□	a Konventa për importin e përkohshëm f [redaktor përgjegjës Drilon Zeka]
327	10	0 Përmban edhe: a Ligji për ratifikimin e konventës për importin e përkohshëm
423	□0	1 2001□ a Ligji për ratifikimin e konventës për importin e përkohshëm 1 5031□ a Ligjet etj. 1 71001 a Kosova (Botimi përmban edhe ligjin, i cili nuk është në faqen e titullit. Të dhënat vendosen në fushën 327 dhe fiksohen në fushën 423 për shkak të kërkimit.)

27. * COBISS.net

200	1□	a Drama moderne f [redaktore Era Rusi]
327	12	0 Përmbajtja në faqen e tit.: a Mbretëresha e zezë / Antigona Aliu a Bukuroshja e fjetur / Melisa Hoxha a Mali magjik / Albana Kokollari
423	□0	1 2000□ a Mbretëresha e zezë 1 700□1 a Aliu b Antigona 4 070
423	□0	1 2000□ a Bukuroshja e fjetur 1 700□1 a Hoxha b Melisa 4 070
423	□0	1 2000□ a Mali magjik 1 700□1 a Kokollari b Albana 4 070 (Regjistrim për botimin që përmban drama. Në faqen e titullit ndodhen titujt e veprave të veçanta të autorëve të ndryshëm, të cilët për shkak të shënimeve të detyrueshme vendosen në fushën 327 dhe fiksohen në fushat 423.)

28. * COBISS.net

200 0▯ **a**Konferenca e 5-të sllovene për mbrojtjen e bimëve **d**5th Slovenian Conference on Plant Protection **e**përmbledhje e abstrakteve **e**= abstract volume **e**6 - 8 mars 2001, Maribor, Slovenia **f**[redaktoi Danica Dobrovoljc, Gregor Urek]
(Regjistrim për përmbledhjen e abstrakteve të punimeve nga konferenca. Titulli dhe informacioni i parë tjetër për titullin janë edhe në gjuhën angleze. Para informacionit tjetër paralel për titullin vendoset shenja e barazimit dhe hapësira "= ".)

29. * COBISS.net

200 0▯ **a**1001 netë
 532 11 **a**Një mijë e një netë
(Regjistrimi për veprën, titulli i së cilës fillon me numër. Forma e zgjeruar vendoset në fushën 532.)

30. * COBISS.net

200 0▯ **a**Murgjit e bardhë **h**+Vëll. #1 **i**Ngritja e manastirit **e**histori nga gjysma e pare e shek. XV **f**Janez Höfler **g**fotografitë Valdete Gashi **g**[përkthyes Valdrin Stefaj]
(Regjistrim për botimin me titull të përbashkët dhe tituj të pjesëve. Çdo pjesë (vëllim) është i numërtuar dhe ka titullin e saj. Termi "Vëll." Nuk respektohet te klasifikimi i regjistrimeve. Përgjegjësitë e ndryshme dytësore shënohen në nënfushat e përsëritura g.)

31. * COBISS.net

200 1▯ **a**Bjeshkët tona **i**Alpet shqiptare **i**Luboteni **f**zgjodhën dhe përgatitën Zeqir Baci dhe Drilon Kajtazi **g**ilustrimet Teuta Demo
(Botim me titull të përbashkët dhe titull të pjesës në dy nivele (shih edhe shembullin 28).)

32. * COBISS.net

200 0▯ **a**Bjeshkët tona **i**Alpet shqiptare **i**Boga **f**autorë Zeqir Baci dhe Premtim Paloka **g**skicat Zeqir Baci
(Shih shembullin 27.)

33. * COBISS.net

200 1▯ **a**Trashëgimia e Fan S. Nolit **j**1918-1965
(Regjistrimi për trashëgimin e Fan S. Nolit. Dokumentet janë nga periudha midis viteve 1918 dhe 1965.)

34. * COBISS.net

200 0▯ **a**Broken April **f**ismail Kadare **g**përktheu Johanson Blair
 500 00 **a**Prilli i thyer **m**gjuha shqipe
(Regjistrim për veprën e përkthyer. Titulli origjinal në gjuhën shqipe shënohet në fushën 500, ndërsa në nënfushën 500m vendoset gjuha e titullit të saktë 200a.)

35. * COBISS.net

200 0▯ **a**Njeriu që vodhi diellin **b**Material muzikor **d**L'homme qui a volé le soleil **f**Albert Rama **g**[redaktore Zoja Vladi]
 510 1▯ **a**L'homme qui a volé le soleil **z**gjuha frënge
(Regjistrim për materialin muzikor me titull paralel në gjuhën franceze. Përcaktimi i përgjithshëm i materialit në nënfushën b bëhet në gjuhën e institucionit që ka krijuar regjistrimin. Sistemi bibliotekar përdor skadat për

katalogun manual, për shkak të përshkrimit shtesë titulli paralel është vendosur edhe në fushën 510.)

36. * COBISS.net

001 □□ 7ba
200 0□ aPërmbledhje punimesh bBurim elektronik fKonferenca X Ndërkombëtare e Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 26 tetor 2012.
(Regjistrim për përmbledhjen e punimeve nga konferenca në CD-ROM. Përcaktimi i përgjithshëm i materialit në nënfushën b bëhet në gjuhën e institucionit që ka krijuar regjistrimin.)

37. * COBISS.net

001 □□ 7cb
200 1□ aБелгијска уметностXIXиXXвека eиз збирке Народног музеја у Београду dL'art Belge des XIX et XX siecles ede la collection du Musée national de Belgrade f[уводни текст и каталог Татјана Бошњак gизбор графичких радова и каталог Драгана Ковачевић gсарадници ЈеленаДергенц, Петар Петровић gпреводMarie-Paule Bertrand-Stanković gфотографије Небојша Борић]
(Shkrimi i katalogimit është cirilik dhe kjo tregohet përmes kodit në nënfushën 0017. Titulli i saktë në faqen e titullit është në shkrim cirilik, ndërsa titulli paralel në latin)

38. * COBISS.net

001 □□ 7cc
200 0□ aПоезија dПоэзия dPoetry dPoesie fЈован Котески f=Јован Koteski gизбор и поговор Венко Андоновски g[препеви на англиски јазик Зоран Анчевски, Драги Михајловски, Дејвид Бовен, на француски јазик Љиљана Узуновиќ, на руски јазик Тања Урошевиќ гликовен уредник Кочо Фидановски]
(Shkrimi i katalogimit është cirilik maqedon dhe kjo tregohet përmes kodit në nënfushën 0017. Titulli i saktë dhe titulli i parë paralel që ndodhen në faqen e titullit, janë shkrim cirilik, ndërsa të tjerët në latin.)